



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.119, Datë 11.05.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A., NË CILËSINË E FURNIZUESIT TË
MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN PRILL 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 11.05.2021, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 68/9 prot., datë 07.05.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Prill 2021”,

Konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) me shkresën e saj nr. 5020 prot., datë 06.05.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin Prill 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021” është 1.5 lekë/kWh.
- **Sasia e energjisë elektrike e prokuruar në treg të parregulluar dhe nga burimet e rinovueshme është 1,554 Mwh.**
- Në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e shoqërisë FSHU sh.a., si dhe

përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin Prill 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

<i>Çmimi i FMF-së për muajin Prill 2021</i>				
Prill 2021			Aplikimi FSHU sh.a.	Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.343	6.343
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.19</u>	<u>0.19</u>
	Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante	Leke/kWh	6.53	6.53
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifë e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifë e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA			10.57	10.57

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria FSHU sh.a., Furnizuesi i tregut të lirë, si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **Prill 2021**, të jetë **10.57 Lekë/kWh**.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga shoqëria FSHU sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit prej **10.57 Lekë/kWh**, për muajin **Prill 2021**.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI